



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës
Ministarstvo Infrastrukture
Ministry of Infrastructure

REFERENCË:				
PËR/ZA/TO/:	Z.Ramush Haradinaj, Kryeministër i Qeveris së Kosovës			
CC:	Z.Pal Lekaj Ministër i MI-së			
NGA /OD /FROM:	Zëvendësministër, Z.Idriz Selimaj			
TEMA /SUBJEKAT / SUBJECT:	Raporti 100-në ditor i punës (01.01.2018 - 10.04.2018)			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension:	Bregu i Diellit Rr.II Lam.IV/3 Prishtinë	Data: Datum: Date:	10.04.2018
PËR INFORMIMIN TUAJ / ZA VASU INFORMACIJU / FOR YOUR INFORMATION				


I nderuar, Kryeministër!

- ◆ Unë Idriz Selimaj nga zyra e juaj e kryeministrit jam emëruar ne pozitën e zëvendësministrit ne ministrin e Infrastrukturës me datë 22.11.2017, efektivisht kam filluar të ushtroi këtë funksion me datë 27.11.2017.
- ◆ Që javën e parë më është dashur të njihem me kabinetin e Ministrit Palë Lekaj dhe praktikat e funksionimit te kabinetit deri ne detaje.
- ◆ Pastaj duke pasur parasysh se angazhimi në ministrin e cila është e strukturuar ne 11 departamente dhe me një staf prej 298 personash, gjithë angazhimi im është fokusuar ne takime njohëse me drejtorët e departamenteve dhe gjithë udhëheqësit e divizioneve në organigramin e Ministrisë.
- ◆ Paralelisht kam bërë punë studimore dhe analitike në periudhat e shkuara të funksionimit të ministrisë në të gjithë departamentet e saj ,dhe kam krijuar një situacion të gjendjes aktuale e cila me ka ndihmuar te nisë rrugën drejt dhënies së kontributit tim në kuadër te kabinetit të ministri në hartimin e politikebërjes në politika zhvillimore dhe menaxheriale të ministrisë.

♦ Kam ndërtuar një kronologji të rregullt të komunikimit në formë elektronike me gjithë raportet javore, mujore, vjetore të departamenteve dhe kam marrë pjesë aktive në implementimin e politikave të ministrit në planet mujore të punës për gjithë departamentet në përgjithësi e në veçanti në departamentin e Inspektimit kam angazhuar maksimumin e kohës tim.



♦ Ju kemi përgjigjur thirrjes së qytetarëve të fshatit Balinc KK-Istog, pas aksidentit fatal ku gjeten vdekjen tri vajza si pasojë e mos përshtatjes së shpejtësisë të ngasjes së automjetit me kushtet dhe kërkesat e shenjave të trafikut. Kemi dalë në vend ngjarje dhe në bashkëpunim me policinë e trafikut rajonal të Pejës kemi konstatuar se në të njëjtën pikë po ndodhin aksidente trafiku të shpeshta dhe kemi dalë me propozime konkrete se çka mundemi ne si Ministri të ndërmarrim që të zvogëlojmë mundësinë e aksidenteve në këtë pjesë. Propozimet tona në konsultime me pjesën e inxhinierisë nga Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve, ju kanë kërkuar kompanisë së mirëmbajtjes së rrugëve dhe njëta ka kryer punimet e kërkuara dhe sipas vlerësimit të policisë trafikut ...Intervenimi i menjëhershëm nga ministria ka prodhuar efekt të jashtëzakonshëm. Shfrytëzohet rastin të ju informoi se reagimi i menjëhershëm ka prodhuar knaqësi të komunitetit të fshatit dhe të njëjtë kanë shfrytëzuar rrjetet sociale duke e vlerësuar lart angazhimin e shpejtë të Ministrisë përkundër kërkesës së tyre të deponuar kohë më parë në Ministrinë e njëjtë të Qeverisë së shkuar.



◆ Në shoqëri me inspektorët vazhdimisht kemi inspektuar mirëmbajtjen e rrugëve gjatë reshjeve të borës dhe kryesisht në ditët me bore dhe acar rrugët nacionale dhe rajonale përfshirë edhe autostradat kanë qenë të qarkullueshme.

◆ Që në ditët e para të komunikimit me Inspektoratin e ministrisë kam konstatuar se numri i inspektorëve është i pamjaftueshëm me u përballë me detyrat e kërkuar dhe kam mbështetur kërkesën e 4 udhëheqësve të divizioneve të Inspektimit se duhet shtuar numri i inspektorëve edhe për 10-të Inspektor, dhe si rezultat DSHP dhe personeli kanë hapur konkurs për shërbime të veçanta 6 mujore dhe janë pranuar dhe vazhdojnë detyrat e tyre edhe 10 inspektor shtesë.

◆ Në Punëtorin e organizuar në Gjilan për dy ditë rresht, në përbërje të gjithë kabinetit dhe gjithë drejtorëve të departamenteve me temën "Rritja e efikasitetit dhe riorganizimi i organigramit në MI-së" kam qenë pjesë aktive në organizim dhe në tema konceptuale rreth organizimit dhe rritjes së funksionalitetit të ministres në përgjithësi. Nga punëtorja e Gjilanit janë nxjerrë disa konkluzioni dhe për jetësimin e tyre është me aktvendim të brendshëm është themeluar grupi punues për "Hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MI-së".

VENDIM

Për krijimin e grupit punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm Sistematizimin e Vendeve të Punës

1. Themelohet grupi punues për hartimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Infrastrukturës në këtë përbërje:

Nebih Shatri- U.D. Sekretar i Përgjithshëm, kryesues;

Rexhep Kadriu- Zv/Ministër, anëtar;

Idriz Selimaj – Zv/Ministër, anëtar;

Fehmi Mujota – Zv/Ministër, anëtar;


Eset Berisha - Këshilltar i lartë i Ministrisë, anëtar;

Linda Osaj - Udhëheqëse, Divizioni i Burimeve Njerëzore, anëtare;


Qamil Feka - Auditor i brendshëm, anëtar;

Njomza Beqiri - Zyrtare ligjore, DL, anëtare;


♦ Në muajin Janar-shkurt vendi ynë ka pasur te reshura të borës dhe temperaturave të ultë, meqë rast çdo ditë kemi qene në teren së bashku me Inspektoratin dhe menaxheret e kompanive të mirëmbajtjes dhe kemi ushtruar ndikimin e kabinetit në rritjen e angazhimit në pastrimin e rrugëve në nivel vendi.




♦ Për shkakun e te reshurave të mëdha të shiut dhe borës në gjithë brezin rrugorë të Autostradës Ibrahim Rugova kemi pasur rrëshqitje të dheut dhe mureve mbrojtëse. Kemi dalë në teren i kemi inspektuar dhe kemi nxitur kompanitë e mirëmbajtjes në marrjen e masave mbrojtëse në pengimin e rrëshqitjeve të mëtejme, pastrimin e dheut dhe hapjen e shiritit qarkullues të rrugëve.



♦ Në segmente të caktuara të brezit rrugorë e kryesisht në pjerrinat në përbërje nga dheu nga absorbimi i madh i ujërave të shiut kë bërë edhe Gabionet mbrojtëse të mos e durojnë presionin e dhe në disa segmente kemi edhe dëmtime të tyre, janë identifikuar operatorët të cilët kanë realizuar këto projekte dhe kemi marrë zotimet e tyre se me tu ndrequr koha, gabionet dëmtuara do të ngritën përsëri.




♦ Përveç dheut dhe gabioneve mbrojtëse në kilometrin e 6 dhe 7-të në autostradës I.R tek e quajtura prerja e madhe shkëmbore, menaxheret e MI-së kanë raportuar se kemi rrëshqitje edhe të gurëve të përmasave të mëdha të cilët paraqesin rrezik potencial të bllokimit të rrugës e keqja më e vogël, eventualisht edhe goditje e ndonjë automjeti pjesëmarrës në komunikacion me premisa fatale. Veprimin e parë që kemi marrë si Ministri kemi kontaktuar kompaninë që ka realizuar projektin “Bektel & Enka” dhe kemi dalë një ekip e përbashkët dhe kemi konstatuar se duhet të merren veprime urgjente në stabilizimin e gurëve që rrezikojnë të rrëshqasin. Bektel & Enka ka marrë përsipër të hartojë një projekt konkret mbi bazën e të cilit do të ndërmerren veprimet e duhura në evitimin e rrezikut potencial.



♦ I nderuar Kryeministër, një pjesë e konsiderueshme e kohës nga angazhimet e pozitës së zv.ministrit është konsumuar nga vizitat në kantieret e realizimeve të projekteve infrastrukturore në nivel vendi, dy vizita ne segmentet e fundit të ndërtimit të autostradës Arbër Xhaferi saktësisht te ura ma e madhe në Ballkanin perëndimor në segmentin e fundit Kaçanik - Elez Han. Pastajë vizita tek ura mbi Lumin Sitnica e cila është në finalizim e sipër në fshatin Plemetin/Obiliq.



♦ Në funksion të ngritjes së bashkëpunimit mes ministrisë dhe komunave me theks të veçantë bashkërendimin e aktiviteteve rreth projekteve infrastrukturore ku financohen nga buxheti i ministrisë, ministri Pal Lekaj ka vizituar shumicën e komunave dhe në pjesën dërmuese kam qenë pjesë e ekipit të tije.



♦ Aktualisht jamë i deleguari i ministrit në takimet që po i zhvillohen zv.Kryeministri Enver Hoxhaj në cilësinë e koordinatorit të Qeverisë së Kosovës rreth përgatitjes intensive për organizimin sa më përmbajtësor të mbledhjes së përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë e cila do të mbahet në gjysmën e dytë të muajit Prill.

Zoti, Kryeministër Ramush HARADINAJ,

Më lejoni të shprehë konsideratën time më të lartë për ju!

Zv.Ministër i Infrastrukturës

Idriz Selimaj_____